

Nga Vasil Vasili per gazetën “Fjala Sot”, Prill 1996

## **Bisede me poetin popullor Zaho Balili**

### **Kush është Zaho Balili, për lexuesit e “Fjala sot”?**

Kush jamë unë? Si gjithë Tepelenasit, lindur në këto troje, rritur mbi këto troje, mbart dëshirat, këngët, dashuritë, dhimbjet. Kam lindur në Rexhin të Labërisë me 1951, kam punuar mekanik jam dashuruar pas këngëve të vendlindjes dhe habitem si erdhi koha që unë bëj këngë për vendin tim, dhe ato të më këndohen në dasma dhe në vetminë e halleve të njeriut.

### **Zaho, po të kërkojmë një datë të “celebrimit” tuaj me këngën, kush do të ishte ajo?**

Do të thosha se këngën e kam patur në gjak si gjithë lebrit, po do të thoja se kënga ime ka lindur kur unë njoha vetveten, pra kur njoha historinë e këtij populli. Në vitet e gjimnazit doja të bëhesha dikushi i këngës. Në 1975-76 dolën këngët e mija të para. Kisha nderuar këngën e lashtë të popullit me vargje të skalitur dhe mendoja dhe ëndërroja; vallë do të vijë një ditë që një grup lab do të këndoje këngët e mija. Kënga ka lindur bashkë me mua, është mbujtur në gjakun tim dhe kam besim se nuk do të vdesë me mua.

Këngën e kam nisur me grupin e Bënçës që ja pëlqejë shumë këngët e fuqishme, por ëndërroja për një këngë që të vinte sa më afër tabanit të popullit, e këndueshme në çdo familje labe. Më pas fillova me grupin e Hormovës. Me shumë punë e sakrifica iu vumë punës për të kthyer për të prurë diçka të re në këngën labe. Dhe ky grup u bë i njohur në Shqipëri, dhe zëri i tij “shëtit” rrugëve te Evropës. Është zëri i shpirtit të Hodo Ziflaj, Ilirian Dino, Agim Ziflaj e Rustem Kokona. Hormovën e quaj vendlindjen e këngës time.

### **Çfarë vendi zë kënga e Hormovës në trevën labe?**

Në 15 vitet e fundit kjo këngë ka zënë hapësira gjeografike të gjera, është bërë e pëlqyeshme, është e afërt me traditën, që këndohet në dasma e gëzime, nga çobanët në male, ajo mbart hallet e të gjallëve. Kënga që mbetet mban historinë e një brezi. Kam shkruar qindra këngë që këndohen që nga Vlora në Sarandë fshat me fshat. Kur i dëgjoj, ngjanjëherë dyshoj që është kënga ime, dhe i hap fletët dhe i sjell ndërmend.

### **-Kush është kujtimi më i “privilegjuar” i këngës suaj?**

Këngët janë si fëmijët. Të gjitha të dhembshura. Por kënga që më bëri me emër është ajo që këndohet nga katërshja e Hormovës “Flaka mbuloi fshanë”. Ajo nuk lindi rashtësisht. Kishim kohë që donim diçka të re për Festivalin e 88-ës. Njihja mirë këngën “Tanë moj Tanë”, dhe po punoja për një valle karakteristike humoristike. Duke ikur nga Uji i Ftohtë për në Hormovë na zuri shiu dhe u futëm në një zis. I them Hodo Ziflajt, që ka një zë për klarinetë me grykë.

- *E bën do atë klarinetën e këngës së Tanës? – e bëj, më tha.*

Kishte ardhur Miçotaqis dhe Gensheri në Shqipëri dhe nuk mund të shkruaja dot për 217 të masakruarit nga grekët dhe 32 nga gjermanët. Atëherë nga shtërngesa për të thënë faktet lindi “Flaka mbuloi fshanë”. U këmbëngul që kjo këngë të mos vinte në festival. Ditën që do këndohej kënga Hodoja ishte i ngjirur. Kur filloi kënga, sikur ja hapi zërin Perëndija Hodos. Dëgjoja dhe qaja mbas skenës.

### **Është një mendim se historia e Shqipërisë është te kënga.**

Është një nga mendimet që unë e përkrah më shumë. Se këndohet kënga që kur ka lindur ky komb, këndohet kënga e Ago Ymerit, kënga e Tanës, kënga e Flamurit. Kush e pruri Skenderbeun? Kur luftoi Skenderbeu s’kishte alfabet. Po Gjorg Golemin, po Tafil Buzin, po Zenel Gjolekën, po gjithë trimat dhe gjithë ngjarjet e mëdha të Shqipërisë? Dhe mbeti historia në këngë. Dhe sot dimë kur, si, me kë kanë luftuar trimat kombëtar. Ne dimë për Ali pashë Tepelenën, mbi kalanë e të cilit po bisedojmë tani, dhe një këngë e kënduar prej rojeve të tij të kalasë na vjen nëpër veshë dhe tani.

### **Një pyetje “provokuese”, a i di emrat e poetëve popullor të vjetër?**

Respektoj rapsodët e Vlorës dhe të Tepelenës. Një ditë me Nexhip Seraj nga Brataj, fshati i Selimit dhe i Mato Brataj më tregoj për Tartar Zekën e viteve 1930. Ai ka shkruar:

“ O i ziu Tartar Zeka  
 Ç’kërkove në qeveri  
 Erdhe vet a të prunë  
 Me një letër përdhuni  
 Atje gjete një të huaj  
 Që i kish turinjt si mi”

Mund të përmendja dhe poetin nga Gusmari, një i verbër që bridhte rrugëve te Gjirokastrës dhe bënte këngë.

### **– Kënga ju ka lidhur me studiues nga Evropa.**

Polifonia është një trevë e parratur dhe e panjohur nga Evropa, që është e ngopur me muzikën rok e të tjera muzika. Pas festivalit të 88-ës një grup studiuesish gjermanë të muzikës kishi përzgjedhur edhe dy këngët e Tepelenës “Flaka mbuloi fshanë” dhe “Kënga e Bilbilenjve”, kënduar nga Rexhini. Midis tyre ishte dhe një vajzë e re. u filmuan dhe inçizuan dy këngët. Mbas shumë vitesh në Festivalin e Beratit 95 me foli: Zao, Zao, Zao... Flaka mbuloi fshanë. Kishte harruar për një çast mbiemrin tim dhe kujtoj emrin e këngës që kisha bërë unë. Ishte Adelheid Feilche.

### **Ç'vend zë kënga në jetën tuaj?**

Kenga zë vendin më të rëndësishëm, por jam edhe familjar i rregullt, por familje për këngën më bën mes, më fal siç themi ne leberit. Mbas Beratit, në rrugët e Lekdushit dëgjova këngën time:

E pse qënkam kështu unë  
Ç'ke o zot që nuk më thua  
Sytë nuk i mbyll për gjumë  
S'bëj siç thonë, por bëj siç dua  
Kur te vinë për në varre  
Trupin tim nuk do ta gjejnë  
E kam shkrirë nëpër vargje  
Suferinës ia kam dhënë  
Se kështu më ke gatuar  
Herë fllad, herë shkëmb  
E di ç'do thuash për mua  
Kur të vi në gjirin tëndë

### **Kushtet e reja të jetës shqiptare po përcaktojnë edhe këngën.**

Në qoftë se kënga labe nuk do të bëhej nëpër skena do te bëhej nëpër familje. Kur thesi i 91-it, ishte shkundur plotësisht, shkopin e parë do ta hante kultura, se ishte sferë joprodhuese, vetëm me ndjenja nuk fuste asgjë në buxhet. Megjithatë u gjendën njerëz që thanë: “Po kënga labe, kënga e vendit tim dhe kënga e gjithë Shqipërisë, ku është? Nga pesë lekë që kemi dy do t'i japim për këngën dhe tre do ti mbajmë për vete. Kështu kënga edhe në shtërngesa ekonomike s'do të pushojë, se do të këndohet në shtëpi e në skena, se do gjenden njerëz që do të bëjnë atë pyetjen tronditëse “ Mor, a do të këndohet kënga labe?”